



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 268, Datë 27.10.2025

MBI

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 40, DATË 14.02.2025  
“MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “EB ENERGY” SH.P.K., NË  
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI  
FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 2 MW”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.10.2025, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme, me nr. 2451/1 prot., datë 24.10.2025, “Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 40, datë 14.02.2025 “Mbi licencimin e shoqërisë “EB ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW”,

**Konstatoi se:**

**1. Të dhëna mbi shoqërinë “EB ENERGY” sh.p.k.**

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 40, datë 14.02.2025, ka licencuar shoqërinë “EB ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW, për një afat 30-vjeçar.
- Në kuptim të sa përcaktuar në pikat 2 dhe 3 shoqëria duhet që të dokumentojë në ERE, fillimin e punimeve për ndërtimin e centralit brenda muajit shtator 2025 si dhe duhet të fillojë operimin/ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda datës 05.12.2025.

**2. Korrespondenca dhe Dokumentacioni i Depozituar nga Shoqëria**

- Shoqëria “EB ENERGY” sh.p.k. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2451 prot., datë 12.09.2025, ka depozituar procesverbalin e nënshkruar midis shoqërisë zhvilluese “EB ENERGY” sh.p.k., subjektit ndërtues shoqëria “KIRAC GREEN ENERGY” sh.p.k., si dhe Mbikëqyrësit e punimeve “HTS” sh.p.k., mbi përfundimin e punimeve të “Ndërtimi i impiantit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet të instaluar 2 MW dhe veprat ndihmëse” me vendndodhje në Topojë, bashkia Fier.

**3. Analiza Ligjore dhe Vlerësimi**

- Me shqyrtimin e kërkesës dhe dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria “EB ENERGY” sh.p.k., mbi përfundimin e ndërtimit të impiantit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike me kapacitet të instaluar 2 MW, së bashku me procesverbalin përkatës të përfundimit të punimeve të datës 10 shtator 2025, vlerësohet se kushti i përcaktuar në pikën 2 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 40, datë 14.02.2025, është i përmbushur nga ana e shoqërisë dhe për rrjedhojë duhet shfuqizuar.

#### 4. Nevoja për Ndryshimin e Vendimit

- Në mbështetje të nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se një akt administrativ mund të ndryshohet, shfuqizohet apo anulohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë për ta nxjerrë atë, vlerësohet se pikat 2 e dispozitivit të vendimit të bordit të ERE-s nr. 40, datë 14.02.2025, duhet të shfuqizohet, pasi shoqëria “EB ENERGY” sh.p.k. ka përmbushur kushtin përkatës.
- Gjithashtu, pika 5 e vendimit nr. 40/2025 përcakton se: *ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.*
- *Në kuadër të plotësimit të pikave 2 dhe 3 të këtij vendimi.” vlerësohet të bëhet: “Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në kuadër të plotësimit të pikës 3 të këtij vendimi.”*

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### Vendosi:

1. Pika 2 e vendimit të ERE-s nr. 40, datë 14.02.2025, shfuqizohet.
2. Pika 5 e vendimit të ERE-s nr. 40, datë 14.02.2025, ndryshon dhe bëhet: *“Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në kuadër të plotësimit të pikës 3 të këtij vendimi.”.*
3. Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme, të njoftojë shoqërinë “EB ENERGY” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, “OSSH” sh.a., FTL sh.a. dhe “ALPEX” sh.a., lidhur me vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrît AHMETI**